



Nenad Milenkovic  
Pronar  
Radio Hit Laser  
Nr. Biz. 70091040 "TV Puls"  
Shillovë, Gjilan

VENDIMI: LIC/KPM-2013/17  
Ref: 1303/441/LIC/II

### VENNDIM

*lidhur me ndryshimin e vendndodhjes së sistemit të Transmetimit të Radio HIT LASER –  
Shillovë, Komuna e Gjilanit*

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio HIT LASER është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është i licencuar për të transmetuar radio programe në Shillovë, Komuna e Gjilanit. Radio HIT LASER është pajisur me licencë afatgjatë të KPM-së më datën 6 tetor 2009, ndërsa më 15 shkurt 2013, KPM ka marrë vendim që pornësia e Radio HIT LASER të kalojë tek "TV Puls" (numri i biznesit: 70091040), me pronarë z. Nenad Milenkovic.
3. Më 10 janar 2012, Radio HIT LASER ka parashtruar në KPM kërkesën për ndryshimin e vendndodhjes së sistemit të transmetimit, për të kaluar në Majën e Gjelbërt, aty edhe ku pronari i ri i Radio HIT LASER, z. Nenad Milenkovic, e posedon edhe tërë infrastrukturën teknike për transmetim.
4. Më 14 mars 2013, Departamenti i Menaxhimit Frekuencor (DMF), i Zyrës Ekzekutive të KPM-së, ka ofruar rekomandime e tyre, bazuar në vlerësimin gjendjes teknike të Radio HIT LASER me transmetim nga Maja e Gjelbërt, që nga muaji gusht i vitit 2012.

### Arsyetimi

5. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.

6. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: “për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”.
7. Neni 6.1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së thekson se: “përveç dispozitave për transferimin e pronësisë të specifikuar në Nenin 5.0, i Licencuari mund të bëjë kërkesë për ndryshimet e specifikuara në paragrafet e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Përhapjes Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit, duke ia bërë me shkrim kërkesën për këto ndryshime KPM-së. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm me miratim paraprak me shkrim nga ana e KPM-së”.
8. Prandaj, në pajtim me nenin 21, paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së dhe 6.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, KPM konstaton se, kërkesa e Radio HIT LASER për ndryshimin e vendndodhjes së sistemit të transmetimit me propozim për kalim në Majen e Gjelbërt, me transmetim në **frekuencën 104.8 MHz** i përmbush standardet e KPM-së për këto ndryshime të licencës së KPM-së dhe nuk ndërhyjnë në sinjalin e subjekteve tjera transmetuese.
9. Arsyetimin për ndryshim të vendndodhjes së sistemit të transmetimit, KPM e pranon si të mjaftueshëm dhe në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, përfshirë edhe shërbimin në interes publik për të rekomanduar miratimin e kërkesës së palës për ndryshimin e propozuar.
10. Me rastin e ndryshimit të vendndodhjes së sistemit të transmetimit, Radio HIT LASER ndryshon edhe kategorizimin e subjektit transmetues duke kaluar nga ai me mbulim lokal në subjekt transmetues me **mbulim regjional**. Në këtë mënyrë, ndryshon edhe niveli i pagesës së takës vjetore për licencë të KPM-së për Radio HIT LASER-in, e cila do të bëhet në pajtim me aktin nënligjor të KPM-së që e rregullon nivelin e taksës për licencë.

### Vendim

11. Komisioni vendosë që Radio HIT LASER-it t’i lejohet ndryshimi i vendndodhjes së sistemit të transmetimit në Majen e Gjelbërt.
12. Komisioni vendosë që Radio HIT LASER të kalojë në kategorinë e subjekteve transmetuese me mbulim regjional, që nga dita e miratimit të ndryshimeve të propozuara dhe të obligojë Radio HIT LASER-in të bëjë pagesën shtesë të taksës për licencë në bazë të dallimit të kategorisë me fuqi të ulët transmetimi dhe kategorisë me mbulim regjional.

### Lëshimi i Vendimit

13. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur për Media dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit.

  
Shefki Ukaj  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur për Media



  
6 gershor 2013  
datë